



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane; nenit 9 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019 dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.03.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË ZGJEDHJEVE TË KËSHILLAVE LOKALE

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Me këtë Vendim formohet Komisioni për koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit në përbërje si vijon:

1. Majlinda Sylejmani nga subjekti politik LDK, Kryesuese
2. Rinor Murati nga subjekti politik LDK, anëtar
3. Lulzim Rrustemi nga subjekti politik PDK, anëtar
4. Fadil Spahiu nga subjekti politik LVV, anëtar
5. Hyra Bytyçi, nga ekzekutivi i Komunës, anëtare
6. Majlinda Krasniqi nga shoqëria civile, anëtare
7. Përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjia urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal, anëtar

Neni 2

Mandati i anëtarëve

Mandati i Komisionit është i lidhur me me mandatin e Kuvendit të Komunës.

Neni 3
Detyrat e Komisionit

Komisioni Komunal ka për detyrë të vazhdojë organizimin e zgjedhjen e të këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane i cili organizim ishte pezulluar përshkak të situatës me pandemi si dhe të kryej detyra tjera të përcaktuara me dispozitat e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019.

Neni 4
Kompensimi i punës së komisionit

Për punën e tij Komisioni do të kompensohet në vlerë prej 30 € (tridhjetë euro) për pjesëmarrje në secilin takim të mbajtur në fshatin, vendbanimin apo lagjen urbane i cili do të evidentohet në procesverbal. Pagesa do të bëhet nga buxheti i Komunës –kategoria ekonomike- mallra dhe shërbime.

Neni 5
Punët administrative - juridike të Komisionit

Punët administrative - juridike të Komisionit do ti kryej Drejtorati për Administratë - Sektori për punë të Kuvendit dhe të Komiteteve.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr. 15-020/02-17239

Lipjan, më 31.03.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

